



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 73 Datë 01.08.2018

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	Qendra Shëndetësore Bubq
Organi auditues	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Durrës
Numri i procedurave të audituara	2 objekte të realizuara nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlerë të vogël
Lloji i procedurës/ave të audituara	“Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”
Konstatimet kryesore	1. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, pika 2, të LPP, nenin 40, pika 1, të VKM Nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, VKM Nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” (në fuqi në periudhën e audituar) dhe Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, të ndryshuar (në fuqi në periudhën e audituar), lidhur me zhvillimin në mënyrë shkresore të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, gjatë vitit 2017.
Masat e marra	Në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 3 anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.